



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:150450

Datë: 02.04.2024

Numri i dokumentit: 05535060

**C.nr.240/13**

**GJYKATA THEMELORE MITROVICA**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani, në çështjen juridiko-kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit me shkrim Fadil Limani, kundër të paditurës Xh. U. nga fsh. K. i M., Komuna M.me bazë kontesti: Rimbursim i dëmit, vlera e kontestit 1.133.00 €, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor të dt. 26.03.2024, me dt. 02.04.2024 nxjerr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I.APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë, dhe **DETYROHET** e paditura Xh. U. nga fsh. K. i M., Komuna M që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e dt.30.07.2011, t'i paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 1.133.00 €, me kamat ligjore prej 8 % duke filluar nga data 12.10.2012, e deri në pagesë definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat 15 ditor nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II.DETYROHET** e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore të i'a paguajë paditëses në shumë të përgjithshme prej 20 €, të gjitha këto në afat 15 ditor nga dita e pranimit te këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit te detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja nëpërmes të autorizuarit, me padinë e dt. 12.10.2012, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka kërkuar që të detyrohet e paditura Xh. U. nga fsh. K. i M., Komuna M, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit, për aksidentin e dt. 30.07.2011, ti paguaj shumën e përgjithshme në lartësi prej 1.133.00 €, me kamat ligjore prej 8 % duke filluar nga data 12.10.2012, e deri në pagesën definitive të detyrimit, ku pas administrimit te provave, konsideroj se u vërtetua baza juridike dhe lartësia e padisë dhe kërkesëpadisë andaj, gjykatës i propozoj të aprovojë padinë dhe kërkesën e saj si të bazuar, i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore të krijuara në lartësi prej 20 €.

Gjykata me datë 26.03.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën ka prezantuar përfaqësuesi i paditëses, ndërsa për palën e paditur nuk ka prezantuar askush, edhe pse është ftuar me rregull, por që mungesën nuk e ka arsyetuar. Gjykata me propozimin e

paditëses e në bazë të nenit 423 par. 4 të LPK-së, ka mbajtur e shqyrtimit kryesor pa praninë e palës së paditur.

Gjykata në këtë çështje juridike - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të paditësit ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: Raporti policor i dt. 30.07.2011, nr. 2011-BR-470; Kopja e librezës së veturës; Kopja e konfirmimit të sigurimit; Kopja e kërkesës për dëmshpërblim i dt. 01.08.2011; Kopja e Ujdisë jashtëgjyqësore e dt. 25.08.2011, nr. 1231/11; Kopja e transferit të pagesës e dt. 12.09.2011.

Gjykata, pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhshmëri njëra me tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundim se në këtë çështje juridike - civile duhet vendosur si në dispozitiv, të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nga raporti fillestar i aksidentit i dt. 30.07.2011 me nr. 2011-BR-470, gjykata ka konstatuar se: Me datën 30.07.2011, ka ndodhur aksident trafiku, me dëme materiale, ku pjesëmarrës në këtë aksident ishte Xh. U. nga fsh. K. i M., Komuna M, e cila ngiste automjetin e udhëtareve të markës R Xh. U. nga fsh. K. i M., Komuna M me targa .-KS-, me regjistrim të skaduar, ku deri te aksidenti kishte ardhur ku vozitësja e automjetit Xh. U., në Rr. Magjistrale P. – M.ë ka shkaktuar aksident trafiku me ç'rast sipas raportit të policisë godet veturën M.-Benz, pronë e B. A. me ç'rast dëmtohet automjeti.

Nga raporti i aksidentit i datës 30.07.2011 me nr. 2011-BR-470 vërtetohet fakti se e paditura me rastin e shkaktimit të aksidentit ka pasur targa por nuk ka pasur regjistrim, sigurim valid, pra ka qenë pa policë të sigurimit.

Nga ujdia jashtëgjyqësore e datës 25.08.2011 gjykata konstaton se i dëmtuari në këtë aksident z. B A, ka lidhur marrëveshje me këtu paditësen, për kompensimin e dëmit material në shumën e tërësishme prej 1.133.00 €.

Nga urdhri i transferit i datës 12.09.2011, gjykata konstaton se Byroja Kosovare e Sigurimeve, ka bërë pagesën e detyrimit sipas ujdisë jashtëgjyqësore të lartë cekura në llogarinë bankare të palës së dëmtuar.

Gjykata pasi vërtetoi këtë gjendje faktike e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 par. 4 të Ligjit nr. 04/L-018 për Sigurimet e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia, aprovoi në tërësi kërkesë padinë e paditëses si të bazuar.

Paditësja është dashur ta kompensojë dëmin të dëmtuarit në aksidentin e komunikacionit rrugor të dt. 30.07.2011, në bazë të dispozitës së nenit 25 për Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto - përgjegjësive, në të cilat shprehimisht parashihet se palët e treta të dëmtuara kanë të drejtë paraqesin kërkesën për zhdëmtim drejtë për drejtë kompanisë së sigurimit, dhe nëse i dëmtuari parashtron kërkesën për zhdëmtim kompanisë së sigurimit, siguroesi si përgjegjeje në kërkesë të tillë nuk mund të bëjë kundërshtimet, që do të mund ti bënte ndaj të siguarit në bazë

të ligjit, ndërsa sipas dispozitës nga neni 18 paragrafi 4 të të njëjtit ligj, Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar shpenzimet dhe kamatën.

Gjykata pasi që shqyrtoi të gjitha provat në shkresat e lëndës e duke u mbështetur në dispozitat e cekura me lartë, erdhi në përfundim se paditësja ka qenë e obliguar ta përmbush detyrimin ndaj të dëmtuarit si pasojë e këtij aksidenti, dhe se paditëses nuk i mungon baza ligjore për të kërkuar nga e paditura rimbursimin e dëmit si shkaktare e aksidentit, për arsye se me dispozita ligjore nga neni 18 par 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm të Auto -përgjegjësise, që parashohin se Kompania e Sigurimit e cila mbulon rastin e pa siguruar, mund të kërkoj rimbursimin e dëmit nga shkaktarja e aksidentit e cila në momentin e aksidentit ka qenë e pa siguruar respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, e ne lidhje me nenin 254 të LMD-së, për çka edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë ti provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe mendimin juridik të Gjykatës Supreme lidhur me kamatë nr. 265/2020 i datës 02.12.2020.

Vendimin që pala e paditur ti bart shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452, e lidhur me nenin 463 të LPK-së, duke mare parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës paditëse dhe atë 20 € në emër të taksës gjyqësore.

Nga arsyet e cekura si më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.240/13, datë 02.04.2024**

**GJYQTARI**  
Genc Hasani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.